



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 17.7.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “EFIÇENCA
ENERGJITIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR”, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR.89/2015”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 17 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjitike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr.89/2015”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Ai shqyrtohet bazuar në nenin 121 të Kushtetutës dhe sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të paraqitur dhe për të dhënë sqarime mbi projektligjin, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Ligji bazë nr.89, datë 23.7.2015.

Ky ligj parashikon marrjen e një huaje prej 12 milionë eurosh nga KFW, me kushte të favorshme, për projektin “Eficienca energjitike përmes sektorit bankar”, në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor. Kjo hua i jepet sektorit bankar për të mbështetur me kreditim ndërmarrjet e vogla e të mesme. Përdorimi i huasë, kushtet dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat

midis KFW dhe huamarrësve. Projekti për efikasitetin e energjisë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

Ky ligj nuk u zbatua dhe huaja nuk u disbursua, pasi siç u evidentua përmes një note verbale të Qeverisë Gjermane në shtator 2017, ky projekt nuk ishte efikas për bankat shqiptare, për shkak të likuiditetit të lartë të sektorit bankar. Pengesa më e madhe për dhënien e kredive nuk ishte mungesa e mjeteve financiare, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve.

Pas diskutimeve, palët ranë dakord për përdorimin e një instrumenti tjetër për promovimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Por, ky instrument nuk mund të vihet në zbatim, pasi ligji nr.86/2015 nuk lejon zëvendësimin e projektit, objekt i tij, me projekte të tjera. Për këtë arsye, lindi nevoja për hartimin e një projektligji për denoncimin e marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr.89/2015 dhe më pas, hartimin e një projektligji të ri për mbështetjen e SME-ve.

Palët kanë rënë dakord që projekti i ri të realizojë mbështetje për SME-të nëpërmjet fondit të garancisë së kredive rurale, duke vënë garanci në favor të bankave dhe biznesit, si dhe duke mundësuar dhënie kredie për ndërmarrjet e vogla e të mesme. Marrëveshja e re do të lidhet për projektin në fushën e bujqësisë dhe do të mundësojë financimin në formën e grantit nga KFW prej 5 milionë eurosh.

Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji parashikon denoncimin e marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr.86/2015. Praktika e denoncimit të marrëveshjeve ndërkombëtare mbështetet në nenin 121 të Kushtetutës dhe ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë“. Nëpërmjet aktit të denoncimit, Republika e Shqipërisë tërhiqet nga një marrëveshje ndërkombëtare. Denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi për marrëveshjet e ratifikuara prej tij.

Vlerësimi për projektligjin.

Komisioni është i mendimit se projektligji është i domosdoshëm, pasi parashikon tërheqjen nga një marrëveshje ndërkombëtare e pazbatueshme dhe i hap rrugën përfitimit të një financimi të ri në favor të SME-ve. Qeveria gjermane dhe ajo shqiptare kanë rënë dakord që promovimi dhe mbështetja e SME-ve në zonat urbane dhe rurale të realizohet nëpërmjet një projekti të ri, që mbështetet në fondin e garancisë së kredive rurale dhe që do të realizohet nëpërmjet hartimit të një marrëveshjeje të re ndërkombëtare. Krijimi i këtij fondi do të mundësojë mbështetjen me kredi të SME-ve në sektorin e bujqësisë, si dhe do të sigurojë më shumë garanci në kthimin e kredive.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash.

RELATORI

Arben PËLLUMBI

KRYETARI

Erion BRAÇE